



Arben
Shehu

Ngjyrat
e zemrës

poezi



SH-1
5439.

Arben
Shehu

●
Ngjyrat
e zemrës

●
poezi

47283

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

V E N D L I N D J E S

Vendlindja ime, një muzg me drita,
para më rri, rrënjosur thellë në sy.
Unë vetvetes çdo gjë aty ia rrita
e nga vetja çdo gjë ia lë me dashuri.

Vendlindja e gurtë, që rrugët poshtë i varen
si duar që zgjaten drejt Drinos me zë,
për një grusht ujë
që buzët e gurta mos thahen,
dhe kujtesën time të njomë se mos fle.

Ato duar të gurta më duken se zgjaten
thellë lëndinash a kodrash buzë lumit.
Ç'kërkojnë? Fëmijnia ime vallë a kapet
kur vetë s'ia di fillimin dhe fundin?

Vendlindjes fëmijnia ime në prehër i mbiu
si një lule pranë gurit të saj të sertë.
Fëmijnia në pemën e jetës së njeriut, —
përjetësisht dega më e blertë.

NE DHE MALET

Ju rrini të rëndë, brinjëzhveshur,
të rrudhur, të menduar për kohët që vanë.
Zjarret e luftërave mbi shpinë ju kanë mbetur
e mërmëri epika për trimat që ranë.

Me majat thikë, holluara nga vitet,
në qiellin tuaj shkruani historinë,
ecurinë e një populli,
jetën e një populli
që mbajtët në shpinë.

Kudo që sillemi,
ngado që shkojmë,
balli ynë me ballin tuaj ndeshet çdo anë.
Historia para jush parakalon,
ndërsa ju nderoni me grusht si veteranë.

NATË DIMRI NË TIRANË

Era dirigjon gëzueshëm shiun,
këtë tamburist të çuditshëm të tokës,
ndërsa antenat mbi pullaze e tarraca
u bëjnë jehonë lajmeve të botës.

Shpejtoj hapin në paqetësinë e motit.
Përreth çdo gjë flet me zë, —
zhurmërima ku shtypet Zëri i Popullit,
dhjetëra targa jashtë që presin atë.

U vonova, po më presin disi gjatë
shtruar të shtëpisë rreth tavolinës.
Trokitjet e gëzueshme të enëve në darkë
pas një akordi gazmor të mandolinës.

Ndoshta motrën e ka zënë gjumi
te një cep probleme faqen mbështetur,
Shahut i ka mbetur lëvizja e fundit,
anglishtes një mësim prapambetur.

Nxitoj hapin dhe jetë lë prapa.
Ndiej aromë kuzhine të nënëmirës
Neonët përkulur butë si xhirafa
udhëve i prishin tisin e errësirës.

ËNDËRR E BARDHË

U zgjova, dritaret hapa. Dikush martohet.
Nën tinguj të tillë kushdo ndihet dhëndër.
Ndaj dorën zgjata në qiell mbi një yll të
bukur,
ta vija në gisht si unazë
dhe prapë të bija në ëndërr.

USHTARI DHE LULET

O lule, mua me maskë kundragazi të
çuditshme
më jeni të dashura
sa në gjumë më rrini mbi qerpikë.
Gjer vonë bisedoj me ju, belkëputura të
ndritshme,
gjersa ulni qepallat e petaleve
e thoni «natën e mirë!»

Në e dashtë atdheu në kohë të mprehta,
e bëj tym e flakë e gjakun më gju,
për ju, të bukurat e mia të ylberta,
plagët do t'i marr të bukura si ju.

E shikoj tek ulni kokat, se e kuptuat
që kundrejt meje bëtë disa teprime.
Dashuria për të mbrojtur bukurinë tuaj
përkohësisht më bëri «të shëmtoj» veten time.

SARANDA

Para se të hysh te ky qytet,
duhet të kesh prerë biletën
tek agjencia e diellit.
Retë supet i vënë njëra-tjetrës
si udhëtarët te sporteli.

Para se t'i kesh trokitur në dyer
këtij qyteti midis dy kaltërsive,
me detin duhet të kesh këmbyer
lajmëthirrje fëmijërie

Para se të hysh te ky qytet,
kaltërsia vështrimin e parë ta ka marrë.
Qielli yjet
si degë me agrume t'i var.

Para se të hysh te ky qytet,
netë të kthjellta të aviten në ëndërr
Këtu dyfishon këngën,
këtu dyfishon zemrën.

BALADË E MARKO BOÇARIT

Ç'trima të dha Suli,
trimëri ia ktheve,
kapedani Marko,
biri i rrufeve.

Nëpër sulme shkabe
mbi osmanët mbete,
ti i dhjetra luftrave,
vetëm me një vdekje.

Një zë oshëtimë
çau në llogore.
Kë mbajnë mbi shpatull?
Vallë një përmendore!?

Kapedanë në radhë
heshtin dymbëdhjetë.
Topat shtij e hesht
në dhembjen e vet.

Brengë hapin dafinat
mbi armët e shtrira,
Vaj Shqipëria,
vaj Greqi, martirja!

Fustanella jote
palat nuk i vari,
se e vësh Xhavella,
se e mban Vasiari.

Dhëmbja më të qe të,
për betim pas mbeti.

... Mos po sjell Bajronin
ajo valë tej detit?

Kapedani Marko,
o Marko shqiptari,
flakën ta tund prapa
Çelua i Picarit.

Ja, te Melesini
ajo flakë u zgjua.
Gjuhë e saj prej gjaku
skuq e ashpërsuar.

STINËT E NJERËZVË

Ti për stinët kërkon ca shpjegime.

Ç'të them për to?

Dihet, katër janë.

Megjithëse jemi të pranishëm mes tyre,
tek ne, nga vetja diçka na lënë.

Për shembull, ti buzëqesh dhe unë shikoj
petale shumëngjyrëshe pranverë buza të
shkund.

Dhe verën në zemrën tënde e ndiej kur
afrohem, kur
kur piqet si pjeshkë nga dashuria e pafund.

Ndodh dhe ndryshe: një dhembje të pushton,
vjeshta merr formë në sy e në faqe.
Natyrisht, dimri të vijë te ti s'e ka zakon,
megjithatë ka ndodhur,
me erë dhe shi të më shfaqet...

Këto për stinët ti patjetër e di,
ndoshta aq fort dhe s'u habitët.
Ç'të them më tepër?
Veç një gjë me siguri
që dhe te njerëzit gjenden stinët.

IKJA E NOLIT

Ku shkoje ashtu aq i menduar,
në ç'dhera hapin e shpije?
Ç'dorë të zgjatej nga balta e huaj
më e dhemshur se kjo baltë Shqipërie?

Në pallat satrapët zunë të miklohen
duke përcjellë netët plot salltanete.
Ti ike, dhe udhëve thellë zgjohen
balada që mërmërinin nën vete.

Malet në mjegull thoshin,
udhët s'ia dimë!
Dhe në ia dimë, s'kemi pas si i vemi!
Ti ike mes dimrit me suferinë
si drejt simfonive të Bethovenit,

Ç'dallgë Rini lajmin ta pruri,
ç'mall Drini zemrën ta mbushi?
Rrudh' e ballit, tribunë e Bajram Currit,
lot i syrit, elegji e Gurakuqit...

AKO ABAZHURIMI KRYEITESH

Dhe fytyra e nënës në këtë përumbje të
si një abazhur pranë të komedialit
Zëri i saj, me atë tingull të ngrohtë të hufje,
më i «efektshëm» se dhjetëra penicilina.

Ajo s'u nda nga unë kaq ditë,
dhe lodhja dritë iu bë për mua,
që mëngjeset t'i shihja
në buzëqeshjen e saj të trandafiltë,
dhe netët të zbuteshin në sytë e saj të

pastruar.

FSHIRESET E NËTËVE TË VONA

Dritën ende s'e kemi shuar.
Rri mbi libër a vargje gjer natën vonë,
ndërsa fëshfërima fshese
dhe i buti zëri juaj,
si vizitorë të vonuar më hyjnë në dhomë.

Fëshfërima e fshesës suaj të përnatshme
më hyn nga nëndera, si një këngë më vete,
dhe më thotë: pa shih, nëpër vargje,
për të fshirë ç'të mbetet?!
Ju afroheni e mua s'më flihet.

Diçka e zakonshme kjo për mua tani, —
pa ju thënë natën e mirë, s'mund të bie...
Fësh-fësh, fshijnë gjumin qerpikët e mi.

Fësh-fësh... në dritare unë kokën zgjat,
ju këndon një motiv të Shqipërisë së Mesme,
ndërsa me fshesë merrni me vete natën
që të na i afroji sa më të lara mëngjeset.

TI VJEN NGA LARG

Ti vjen nga larg. Një fishkëllimë sirene
lajmëronte ardhjen në hyrje.

Qindra njerëz presin në stacion
të dashurit e tyre.

Dikush në vend të dorës
zgjat buzëqeshjen e ëmbël,
ndërsa unë krahët shtriva si zgjatim shinash
për të më hyrë drejt e në zemër.

49283

NJË NATË

Një qiell i ftohtë me yje u mbush.
I vetëm ecja rrugës dhe ndieja
se duhej të mbështetesha diku:
te një fjalë, një këngë, një ëndërrim...
Ngrita kokën dhe qielli m'u duk
si një mangall me thëngjij
ku ngroha vështrimin tim.

I MARR LEJE TOKËS

Marr në dorë çelsin te sporteli:
dhoma 5; në katin e gjashtë!
Na duket sikur jemi pranë qiellit
në këtë hotel Turizmi, Sarandë.

Qielli të shkel syrin e hënës,
në intimitet, moshë e dëgjojnë yjet-rubinë.
Jam mik i tokës — gjithmonë kam thënë
Por sonte këtu, mikeshtë kam kaltërsinë.

Lartësia të bën zog në fluturim.
Mbi krahë vura ëndrrën e vonë.
Sonte s'kam qerpikë mbi sy
por palma që mbrëmjes pikojnë neonë.

Ndonëse ky muzg më fanitet i artë,
lloj trillesh ëndërruese më pushtojnë kokën.
Po sa herë vështrimin e ngre lart,
i marr leje tokës.

PUNËTORI XHA BRAÇE

Çdo gjë përreth kumbon zë jete,
dhe tubat që incizon i japin melodi.
Mbi thinjat, kasketa e kuqërreme
sikur ka varur diellin mbi sy!

Në pushim hap paketën «Partizani».
Thith ngadalë cigaren, thua ndez kujtesën,
dhe duket, nga tymi i duhanit
do nxjerrë një legjendë të re për mbesën.

Pastaj, çohu, bir, se u bëmë ca vonë!
Dhe niset i pari në makineri.
Tok me tubat që bashkë incizojmë,
unë incizoj dhe një motiv të ri.

NË BUTRINT

Amfiteatri. Zëra të mbytur tragjedish të
hershme.

Ç'janë këto guatje të lashta?

Vesh po mbani?

Të duket sikur ecim në të djeshmen
mbi rreshtat e «Bretkosës» së Aristofanit.

Diku në cep të shkallëve u shfaqe ti
me sytë mbërthyer në një skaj rrënimi.
(Kuja e vajzave të lashta hutim në ballë të
rri).

Ndoshta dikush profilin tënd ka pasur
që rri vështron si një statujë e përkryer
ëndërrimi.

Në këtë masiv të patundur monumentesh
zgjaten pafundësisht vitet ilire.

Inicialet e datave mbi trupat e mermertë —
kompesim gjymtyrësh në ekzistencën e tyre.

Mirupafshim, duan të thonë
gojët e copëzuara, të sinqerta,
sytë nga koha të mjegulluara, të përhimë.

Mirupafshim,
dikush la në librin e përshtypjeve.

DUKE TË PRITUR TY

Kam shumë për të të thënë sonte.
Fjalët si gurë të bardhë kilometrikë te rruga
e ardhjes.

Nxito, e dashur, kush të ndali?
Ato po pëshpërisin: ti do njohësh
kufirin e mallit.

Nxito, e dashur, mbi padurimin tim
kam shumë për të të thënë.
Ti e kupton sa mund të të thotë i dashuri
nga e hëna në të hënë.

Ti patjetër do vish, ndaj të pres te kjo udhë
e hënuar.

Në ecjen e njerëzve të dashur
diçka mund të ndodhë.

Ti do vish si ajo sportistja e vonuar,
edhe pse s'arriti të prekë e para fillin e kësaj
ore.

Ora kaloi,
dhe mendimet s'm'i turbulloi vetmia.
Kush tha se takimet kanë vetëm orë të sakta?
Vetëm ata që kanë frikë nga dashuria.
u tremben pritjeve të gjata.

VAJZAT AKSIONISTE

Fushat simetrike u dukën që larg.
Çarçafi i pambukut mbi gjethe u var.

Të duket se qielli këto ditë shtatori
petalet e fundit dëborës i hodhi.

Mëngjesit në fushë vajzat aksioniste,
tabloja e madhe e motivit niste.

Me mëngën e bluzës plot delikatesë
nga shtrati i ballit fshijnë të ëmblën djersë.

Te imazh i bardhë çdo gjë kristaline,
shohin nëpër vite diçka më intime.

Lart një re fluturore si shami aksioni
mbi qafën e diellit papritur qëndroi,

Çdo orë që kalonte, futat mbushnin gjitë.
Hartë e bardhë e fushës po humbte kufijtë.

Reshtat mbetën pas me dritë bardhësie
posi copëra vargjesh të një poezie.

BOTA E PUNËS

Në darkë kuvendonim mbledhur rreth
trapezit,

ndërsa ti nëpër dhoma
hyr e dil me këngë.

Ti, më buzagaz se dielli i mëngjesit,
ti më e butë se netët me hënë.

E ikje mëngjesit si dritë mëngjesi
në punë me shoqet aty në frutore.
Ti, më e thjeshtë se darka rreth trapezit
që na shtroje mbrëmjeve verore.

Puna hidhte mbi ty aq dritë!
Ç'kaltërsi mbi kokë qielli të shtinte!
Kur vije, ndër sy të gjelbëronin ullinjtë
e buzëqeshja për ne
si një pjeshkë e purpurt të rrinte.

Vije te kjo rrugë, ku gjarpëronin
aq blerime lulesh
me ngiyra dielli në petale.
Te çdo rrudhë — çelur një bisk limoni,
te çdo fjalë — mbirë një portokalle.

M A L L

Më mori malli të rri prapë aty
buzë rrugës, te ahu mbështetur.
Nën ritme sekondash të ndiej përsëri
hapat e tu
që në zemër më kanë mbetur.

Mëngjeset e njerëzit mbeten po ata,
të përditshmet që ndeshim shpesh.
Ahu nga pritja ime ka marrë dhe gjethet,
kush e di në ç'formë
te këmbët t'i hedh!

ZGJIM NË MËHALLE

Florenti u zgjua.
Dora e tij thua do të prekë çdo zile porte.
E di që s'arrin dhe u troket me sy për
mëngjes.
E ndien, diku brenda gjyshet në dritare
rrufisin diellin si filxhanin e kafesë.

Ti, gjysh me pak kollë, mos u bëj merak,
nistën dhe unë, Florenti, të të sjell një taksi!
Ti për vete s'ke qejf të shkosh në ambulancë,
por përrallat që më thua,
kanë nevojë me siguri.

Yjet e agimit i njeh Florenti
ashtu si germat e abetares së tij.
Dhe kush lind në mëhallë,
vrapon mos i vë emrin
e një ylli që di.

Shkojnë njerëzit, i sheh në sy — kush ta
përkëdhelë!

Hë, ç'bën, mor i miri çamarrok?

Pastaj largohet te një pemë i

ku ka lënë takim me një zog.

Zogu s'vjen. Kushedi ç'kopsht yllkash
e ka thirrur për bisedë!

Kujtohet, nxjerr nga çanta me dashuri shumë
pak bukë me gjalpë e reçel:

«Ja, i flet një zogu, mos shko nga arat me
grurë,

se unë s'kam shok rebel!»

Kështu e gjejnë mëngjeset Florentin,
me një këngë që s'dihet ku mbaron:
shtatori i dha vargjet e para,
prilli refrenin ia cicëron.

MOTIV I HERËT MËRGIMI

Ikin dhe nuk dinë
ç'ka botë e përtejme!
Trastat do na kthehen
arkivolë të djemve.

Në sup — një mal halle,
në shpirt — një fill shpresë.
Në buzë mërmërima:
«mbeçë, o shokë, mbeçë!...»

Vaj në breg të fshatit,
kujë te maj' e kodrës:
djemtë yllorë të prindërve
humbin prapa botës!

Etrit mbenë me shpata,
djemtë me trastë ku venë?!
Shqipëri e bardhë
nën uri të verdhë!

Trastën, bir, s'jua fryn
asnjë derë bote,
veçse zemra jonë,
veçse arma jote!...

E SHTUNA

Kjo ditë qëndron mbi kryet e javës
si një degë mimoze mbi supet e vajzës.

Kjo ditë na i njuh oraret, takimet,
vajzat presin djemtë nën degë pishe.

Këngët shpesh dyzohen në skenën e mbrëmjes,
kush vallë bëhet nuse pa një mall në zemër?

Vogëlushët çantën e hedhin hareshëm,
zërat këtë muzg në yje e veshën.

Dhe mbete në ikje, si në ardhje mbete,
orbitë një javore rreth boshtit të njerëzve.

PEIZAZH NË KALANË E KRUIJËS

Bari në guvat e mureve të hirtë —
e geshura stinore e murimit. —
u kujton qëndresën atyre që ikën,
që dhe nga varret
i peshpëritin blerimit.

ME TY NË BREGDET

Këtë mbrëmje ç'më je kaq e bukur, diellore!
Çdo fill floku me një rreze dielli përçafuar.
Karfica nën flokë
me një zgjatje të ëmbël harkore,
si Karaburuni mbi valët e buta të detit të
shtruar.

KUJTIME TË KALTRA

Ç'të përkëdhel më parë,
zemrën mbi ç'kujtime ta vë?

Tek unë mbeti e dashur gjithçka aty
ku dielli mbi horizont buzëqeshjen e fëndit
më,
mbi muzgun e kaltër e në sytë e mi.

Kërkoj atë skicë, atë emër, thjesht një vijë...
Atë mendim të pastër naiv fshehur në dy

guaska.
Ku vanë?!

I mban deti në akuariumin e madh të tij
të m'i rrezëllijë tërë jetën
si kristale të pastra.

O kështu i vonon i mendoj
që të shprehësh në këto
është tërëjtë e të gjithë këto
lëtar

E SHKRUAR ME 31 DHJETOR

Dikë nga ne kjo natë pranë familjes s'e ka
zënë.

S'e gjen midis miqsh të dashur e të afërt në
dhomë.

Ata rrinë në detyrë
dhe gotat i trokasin me yjet e me hënën,
gjithë kupat e yjeve t'i kthejnë për të
ardhmen tonë.

Nën drita neonësh rrugët rrinë zgjuar,
ndoshta mendojnë
se këtë natë të gjithë i braktisin!
Vetëm vitrinat, si vajza me faqe të lëmuara,
i rrinë besnike tejmesnatës së fundit të vitit.

O kalimtar i vonuar i natës,
që të shoh kur s'më zë gjumi,
trokite hapin te unë si gotën me të tjerët këtë
natë!

S'edhësh kurrë mbremje të fundit,
vetëm fillime mëngjesesh të pambaruar, të

mënsob em azent e gjatë,

Në të tilla mbremje s'na duhen shumë fjalime
Mbi penët e Vitit të Ri t'i varim oratoritë.
Koken pak të mbështesim në mjegull të

ashtu qetë, skaltër kujtimesh
si fëmijët të djepi që i rrit.

Gëzuar, le t'i shkrehim dhe haretë e fundit
për të!

Çifte të lumtura,
fëmijë si mëngjesi qeshin e vallëzojnë.
Vajzat e sapomartuara, me dhembshurinë e
nënës
muajt e ardhshëm kur do lindin ëndërrojnë.

Po ti ku je këtë mbremje, studentja ime
e parë!
Ku t'ju kërkoj, gotën të trokas për të gjitha
dashuritë?

Telefoni hesht, sikur 15-ditshin' e lejes ka
marrë,
ç'të bëj, e trokas me dorezën,
mos shkund copëra nga zëri yt.

Gëzuar të gjithë në këtë ditë fundviti,
ngado që tryezat ju kanë ftuar këtë natë!
Te kjo derë urimi vitet po na ikin,
te kjo derë urimi ndien, trokasin prapë.

JANARI

Kështu na është shfaqur në vite,
si një filozof i bardhë në mbyllje të muajve,
me ca drita sipër vetes të marra në ecje,
me ca fjalë si kristalet e borës,
që më vonë shkrihen në buzëqeshje.

Janari mbi kokat e fëmijëve vuri kapuçat
e bardhë

si stendat e Skotit në Arktik.

Të qeshurat e tyre rëshqasin si slita
duke mbartur gëzimet në një gëzim.

Hapësirat e bardha ze i zgjeron janari
në një fluturim zogu në qiellin e përhimur,
dhe paksa te ky emër ndalemi,
diçka i marrim duke ardhur,
diçka i japim duke ikur.

MBRËMË RA BORË

Mbrëmë ra borë.

Mbi parkun e zemrës
zbardhoi bora virgjine.

Ti nuk erdhe, të prisja,
që gjurmët e para aty t'i lije.

Mbrëmë ra borë.

dhe m'u zgjuan kujtimet e bardha
që fluturonin si një varg rosash
në horizontin gri.

Me një ortografi kralesh të rregullt
diçka shkruan për ty.

Mbrëmë ra borë.

Borëronte tejmbanë një uverturë e ëmbël.
Kisha frikë të ndizja radion,
vetëm abazhuri dirigjonte motivet e këngës.

Tek binte borë,

sytë vetvetiu mbi xhamë mbetën.
Befas më mori malli për yjet
dhe prisja një letër.

«NJERËZ, JU KAM DASHUR...»

Julius Fuçikut

Hapa të rënduar korridoreve të zymta,
lehje qensh, llozet e dyerve
shkrydhnin kyçet orë e minutë.

Pranë frymëmarrja e shokëve, t'i përmendi
ëndrrat.

Agimi i pranverës dha dritë diku në dhomë,
dhe ti u mbështete tek të dy, se besoje
mushkëritë e Lirisë janë te frymëmarrja e lirë
e njerëzve
dhe dritat te sytë që ëndërrojnë.

Heshtje. Dhoma e ekzekutimit.

Fricët si tabela të murrme mbërthyer në
heshtje,

te fytyra e tyre gjithkush
lexon vetëm vdekjen.

Te trupat e shokëve pa jetë,
që tundeshin litarëve të atij vargu,
Julius, ti pe se kambanat e lirisë
pò binin së largu.

Julius, ç'mendon vallë?
Një trokitje. Nën derë dikush fut ca fletëza.
Ç'do shkruash? Ç'të thuash më parë?
Që nga shokët e gjer te vetvetja.

Dikush u përkul pas të shtënës.
Dikush u stërzgjat pas varjes.
Në këpucët e dala nga këmbët
jeta prapë po ecte drejt të gjallëve.

Te ti jeta gjeti njeriun,
vdekja kundërshtarin.
Dhe këta rreshta mbeten hapur përjetë:
Njerëz, ju kam dashur! Jini vigjelentë!>

LARTËSIA JOTE

(monolog i shokut tim pilot)

Ja, Alpet... mbështjellë
në muzg manushaqe...
Ç'janë ato legjenda
që nga thellë shfaqen?

Blloqe përkrenaresh,
maja jataganësh.
Mbi tela lahutash
zëra prej luanësh.

Si më shkelin syrin
me një ankth nën vete
qindra përbetime,
mijëra amanete!

Fluturon avioni
mbi dheun prindëror.
Feks duralumini
me shkëlqim diellor.

Mbrëmjeve në bjeshkë
ç'bukuri e madhe!
Varg kostelacionesh
ulur përmbi male.

Përmbi rrudha malesh
si linja epike,
shkëlqimi i avionit
hedh reflekse drite.

Nën avion, tarracat
si gjerdan plot nure,
rendin vrap, të thonë:
«kë do?» «zgjidh e vure!»

Mbi viset e mia
krahët tund avioni,
thua i rreh zemra
si nga emocioni.

Krahët majtas, djathtas
sillen në ekuilibër,
çdo skaj të Atdheut
puth me mall nga sipër.

Tufa resh, si dele
lart përreth më rrinë,
sikur diç do thonë
me një blegërimë.

Por sot kam detyrë,
dele, sot kam halle!
Nuk ma ndieni radion,
s'i njihni sinjalet?

Çaj, dhe retë në qiell
hapen dega-dega
posi fustanella
që vishte Gjoleka.

Kokë më kokë prapë mblidhen
tufa bardhë si shkumë,
si qeleshet tona
që i duam shumë.

Ja, vendlindja ime,
kaloj mbi krahinë!
Që jam, unë, çapkëni,
sheshet ku ta dinë!?

Ku ta dijë arra
që nën të u rrita!
(Nëpër degë të saj
qiellin e sodita.)

Syrin poshtë nën gjethe
qiellit ia vija.
Me blerim të pemës
puthej kaltërsia.

Pastaj zogjtë nga dega
nisnin fluturim...
Zogjtë, imazh i parë
i avionit tim.

Iknin sa u zhdukjin
si një pikëz muzgu...
Tek më humbte zogë,
niste ëndërr e bukur...

Përrallat e gjyshes
me mister gatuar:
fluturim qilimash...
Unë aty-kaluar.

Ku veja, s'e dija,
veç në qiej pa anë,
posi zogjtë qëndisur
përmbi xhamadanë.

Radiodhënia e parë
në botën e tërë,
tregimi që gjyshja
me nipët ka bërë.

Ikën fantazia,
ikën tutje koha,
derisa avionin
unë, pilot, takova.

Ç'më kumbon motori
posi simfoni.
(Zëri i ngrohtë i gjyshes
aty diku rri).

Nër valvul' e tela,
nëpër ca të dala,
don të flasë, po skuqet
dhe i merret fjala.

Lart avioni im
si me këngë ngjitet.
Gjyshe, për ty nipçja
shih si shket, si shqipe!

Siç na ëndërruat
u bëmë shqiponja,
se ky qiell është yni,
se kjo tokë është jona.

P E R M B A J T J A

Vendlindjes	3
Ne dhe malet	4
Natë dimri në Tiranë	5
Endërr e bardhë	7
Ushtari dhe lulet	8
Saranda	9
Baladë e Marko Boçarit	10
Stinët e njerëzve	12
Ikja e Nolit	14
Abazhur mbi krye	15
Fshirëset e netëve të vona	16
Ti vjen nga larg	17
Një natë	18
I marr leje tokës	19
Punëtori xha Braçe	20
Në Butrint	21
Duke të pritur ty	23
Vajzat aksioniste	25
Bota e punës	27
Mall	29
Zgjim në mëhallë	30
Motiv i hershëm mërgimi	31
E shtuna	34
Peizazh në kalanë e Krujës	35
Me ty në bregdet	36
Kujtime të kaltra	37
E shkruar më 31 dhjetor	38
Janari	41
Mbrëmë ra borë	42
«Njerëz, ju kam dashur...»	43
Lartësia jote	45

Shehu, A.

Ngjyrat e zemrës. Poezi: [Red.:

P. Jorgoni]. T., «Naim Frashëri», 1986

f. 52.

(B.m.) dhe

(B.v.) : 891.983-1

Sh 39

Tirazhi 1000 kopje Formati 70x100/32 Stash: 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1986

